




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr. 561/350-64542 datë: 21.10.2021
REFERENC-Ë:	07Nr.350-64542 datë: 15.10.2021
PËR/TO:	Murat Bytyqi, rruga "Jeronim De Rada" – Suharekë. Nr.Telefonit: [REDACTED]
KOPJE/copy:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: U.D Nexhmije Loshi Durmishi da [Signature] Punoi: Sedat Bytyçi, inxh.dip.ndërt. [Signature]
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Leje Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350-64542 datë: 15.10.2021 nga Murat Bytyqi nga Suhareka, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim banimin individual me etazhitet P+3, në parcelën kadastrale 00778-1, me numër referues të çertifikatës 1836/2021 datë 15.10.2021, Zona Kadastrale Suharekë pronë e Murat Bytyqit 1/3, Faik Bytyqi 1/3 dhe Shiqeri Bytyqit 1/3 sipas pëlqimit mbi të drejtën e investimit. Andaj pas shqyrtimit të kërkesës ky organ vendos, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

• **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Data: 21.10.2021

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr. 561/350-64542

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, neni 2, pika 2.2 dhe 2.4 të vendimit për aprovim të taksave administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit për kategorinë e I-rë dhe të II-të, lejes së rrënimit dhe tarifën rregullative për rritjen e densitetit të ates tructures të Kuvendit të Komunës Suharekë: 01-Nr-016-21653, të ates: 29.03.2019 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Murat Bytyqi-Suharekë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë :

**AKTVENDIM
(MBI LEJE NDËRTIMORE)**

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	MURAT BYTYQI	Nr. Personal	
Adresa:	Rr." Jeronim De Rada ", Suharekë	Telefoni:	
Email :	-	Kërkesa Bazë:	Aplikim për leje ndërtimore: 07Nr.350-64542, datë: 15.10.2021

Emri i Projektit:	OBJEKT- ME DESTINIM BANIM		
Emri i Projektuesit:	" Point Konstruktion " SH.P.K Prishtinë		
Adresa:	Rr."Vëllezërit Fazliu" nr.1 , Prishtinë		
Telefoni: +383		Emaili:	-

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI			
Adresa: Rr." Fan Noli", SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	Koordinatat e objektit-Shënimi(Piketimi):	
Sipas çertifikatës me nr. të lëndes : 1836/2021, datë 15.10.2021, Zona Kadastrale- Suharekë	00778-1	1 X = 7485608.309; 2 X = 7485615.458; 3 X = 7485620.984; 4 X = 7485613.8343;	Y =4691106.139 Y =4691112.319 Y =4691105.926 Y=4691099.746

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt-me destinim banimin			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Sipërfaqja	Sipërfaqe bruto e objektit 343.328m ²	Katshmëria:	(B+P+3)
Vija rregullative	Nga aksi i rrugës "Fan Noli" 5.25m'	Vija ndërtimore	Sipas Aktvendimit mbi Kushtet ndërtimore: 07Nr.511/350-38079; dt.10.09.2021, nga aksi i rrugës "Fan Noli" 3.25m'

Përshkrimi i lejës ndërtimore
Me këtë vendim, parashtruesit të kërkesës për leje ndërtimore ndërtimore Murat Bytyqit nga Suhareka i lejohej ndërtimi i objektit banimor me etazhitet B+P+3. Lokacioni i objektit është në kuadër të PZHU-së, 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelën kadastrale 00778-1, është tokë ndërtimore me destinim zonë qendrore banimore. Objekti shtrihet në pjesën me destinim Zonë Qendrore Banimore. Objekti ka karakter të përhershëm me katshmëri (B+P+3). Ndërtimi i objektit të bëhet konform Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.148/350-3556, datë: 05.03.2021. (Ku Kushtet Ndërtimore ndryshojnë sa i perket etazhitetit nga P+3 në B+P+3), si dhe projektit kryesor hartuar nga byroja projektuese: "Point Konstruktion" SH.P.K, Prishtinë". Objekti është lejuar të ndërtohet me sipërfaqe bruto të objektit 343.328 m². Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ. Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që: • Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin. • Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme: - Informata mbi Lejën Ndërtimore; - Informata mbi Projektuesin; - Informata mbi Kontraktuesin; - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit. • Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme: - Një kopje të kësaj leje ndërtimore; - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit; - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent; - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit; - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit; - Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha

punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;

- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njejtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar s y e t i m

Aplikuesi **Murat Bytyqi** nga **Suhareka**, përmes kërkesës 07Nr.350-64542, të datës: 15.10.2021, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit shtëpi individuale për dy familje, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.511/350-38079, datë: 10.09.2021.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr. 106/21, të datës: 16.07.2021, lëshuar nga NPRM “ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Dëshmi për pagesën e taksës administrative për Leje Ndërtimore sipas njoftimit 07Nr.213/350-19049, datë: 14.04.2021, në shumë prej: 1,459.93€, e paguar në postën e Kosovës në Suharekë, datë: 20.10.2021, sipas faturës komunale nr.0000753, datë: 20.10.2021.
- Pëlqim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjetllësit dhe Kanalizimit –Hidroregjioni Jugor Prizren Nr.152, datë: 23.07.2021.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor – nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09 Nr.2395, datë: 10.09.2021.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.978, datë: 16.09.2021.
- Koordinatat e objektit të vendosura sipas kushteve ndërtimore.

- Pëlqim nga bashkëpronarët e palujtshmërisë për ndërtim Nr.LRP 9274/2021, datë 23.07.2021.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform PZHU-së 01Nr.5820 datë 05.03.2008, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë
Numri i vrojtimit i lejes 07Nr. 561/350-64542 datë: 21.10.2021

Vendimi i dërgohet:

-Parashtruesit të kërkesës;
Inspektoratit të Komunës;
Dosjes së DUP-së

U.D Drejtori i Drejtorisë:
Nexhmije LOSHI DURMISHI

